



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 12. Dhjetor 2001  
Nr. ref.: RK170/11

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI84/11**

Parashtruesi

**Rexhep Ademi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të vërtetuar të Komisionit për  
Kërkesa Pronësore dhe Banesore HPPC/REC/101/2008, të 19 qershorit 2008**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi**

1. Parashtruesi i kërkesës është Rexhep Ademi nga Mitrovica, Komuna e Mitrovicës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e vërtetuar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (në tekstin e mëtejshëm: KKP) KKP /REC 101/2008, të 19 qershorit 2008, me të cilën vërtetohet vendimi i KKP /d/108/2004/C, i 13 shkurtit 2004.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekti i çështjes është Vendimi i vërtetuar KKP/REC/101/2008, i 19 qershorit 2008, me të cilin, sipas pohimeve të parashtruesit të kërkesës, është shkelur neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Karta Sociale Evropiane e vitit 1996.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa është parashtruar në bazë të neneve 113. 7 dhe 21.4 të Kushtetutës, neneve 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullit 56.2 të Rregullores së punës.

## **Procedura në Gjykatë**

5. Parashtruesi i kërkesës, më 21 qershor 2011, ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 26 korrik 2011, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar z. Rexhep Ademi dhe Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP) që është pasardhësi ligjor i KKP, se është iniciuar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë në rastin nr. KI. 84/11.
7. Më 29 gusht 2011, në përgjigjen e saj AKP ka njoftuar Gjykatën për hollësitë lidhur me procedurën për vendimin KKP/REC/ 101/2008, të 19 qershorit 2008.
8. Më 13 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese ka kërkuar nga AKP që të paraqesë dokumentacion shtesë me dëshmitë se kur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës vendimi i KKP/REC/101/2008, i 19 qershorit 2008.
9. Më 17 tetor 2011, AKP i ka dorëzuar Gjykatës Kushtetuese kopjen e fletëkthesës me dëshmitë se parashtruesi i kërkesës më 31 mars 2011 ka pranuar Vendimin e KKP/REC/101/2008, të 19 qershorit 2008.
10. Më 21 nëntor 2011, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues i përbërë nga: Almiro Rodriguez (kryesues), Dr. Gjyljeta Mushkolaj dhe Dr. Iliriana Islami, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që të refuzojë kërkesën si të papranueshme.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Komisioni për çështje banesore i Industrisë së Materialeve Ndërtimore, në Zvečan (në tekstin e mëtejshëm: IMNZ), me Aktvendimin nr. 220 të 26 marsit 1980, për shfrytëzim të përkohshëm të banesës, i ka dhënë parashtruesit të kërkesës për shfrytëzim të përkohshëm banesën që gjendet në ndërtesën e Drejtorisë së vjetër në Mitrovicë.

12. Sipas pohimeve të parashtruesit të kërkesës, ai ka jetuar në banesë me 6 anëtarë të familjes “deri në fund të gushtit 1998 kur forcat paramilitare serbe duke përdorur dhunë e larguan nga banesa...”.
13. Pas luftës ai u kthye në banesë, mirëpo në KKPb është krijuar procedura sipas kërkesës DS 3099075, ku V.G., ka paraqitur kërkesë me të cilën ka kërkuar që t'i kthehet në posedim banesa në rrugën “Gavrill Principi” 231.
14. Me vendimin e KKPb/D/108/2004/C, të 13 shkurtit 2004, e drejta për posedimin e banesës është vërtetuar në favor të V.G., dhe ky vendim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 nëntor 2007.
15. Ndaj këtij vendimi të KKPb/D/108/2004/C, të 13 shkurtit 2004, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kundërshtim.
16. Në procedurën e shqyrtimit të sërishëm me Vendimin e KKPb/REC/101/2008, të 19 qershorit, është vërtetuar Vendimi i KKPb/d/108/2004/C, i 13 shkurtit 2004, në të cilin është vërtetuar e drejta për posedimin e banesën në favor të V.G.
17. Banesa edhe më tej ka mbetur në posedim të parashtruesit të kërkesës në të cilën, sipas pohimeve të parashtruesit të kërkesës, “*jeton për 18 vjet pa ndërprerë*”, për çka edhe e ka vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti i Pavarur i Drejtorisë për Çështje Banesore dhe Pronësore.
18. Vendimi i KKPb/REC/101/2008, i 19 qershorit 2008, bëhet i plotfuqishëm, që është në përputhje me këshillën për mjete juridike sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 23/1999 dhe nenin 2.7 që tregon:

*Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për t'u zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.*

19. Më vonë, parashtruesi i kërkesës lidhë kontratë për qiranë e pronës së paluajtshme me AKP. Më 27 maj 2011, AKP ia dërgon vërejtjen e fundit për të liruar hapësirën e qirasë, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve të kontratës së qirasë (mospagesa e qirasë). Në vërejtjen e fundit i është bërë me dije se, nëse nuk i përmbush detyrimet e kontratës të përcaktuara në kontratën e qirasë deri më 2 qershor 2011, AKP do të detyrohet të ndërpresë kontratën e qirasë.
20. Më 15 qershor 2011, AKP ka larguar parashtruesin e kërkesës dhe familjen e tij nga banesa për shkak të mospagesës së qirasë.

### **Pretendimet e parashtruesit**

21. Parashtruesi i kërkesës është i bindur se të drejtat e tij si qytetar i Republikës së Kosovës i janë shkelur nga ana e KKPb dhe më vonë edhe nga trashëgimtari i tyre ligjor-AKP, dhe që vendimet e nxjerra janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe me dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
22. Parashtruesi i kërkesës konsideron se vendimi i AKP është në kundërshtim me nenin 22 të Kushtetutës që parasheh zbatimin e drejtpërdrejtë të Marrëveshjes dhe Instrumenteve Ndërkombëtare, e të cilat kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të gjitha dispozitat ligjore dhe aktet tjera të institucioneve publike, pra në këtë rast ka ardhur deri te shkelja e Kartës Sociale Evropiane të vitit 1996.

## Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pohon se neni 22 (Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjes dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) i Kushtetutës së Kosovës dhe i Kartës Sociale Evropiane të vitit 1996, janë bazë e kërkesës së tij.
24. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:  
*„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.“*
25. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, par. 28. i Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
26. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, të 31. majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk pohon se në çfarë mënyre neni 22 dhe Karta Sociale Evropiane e vitit 1996 mbështesin kërkesën e tij, ashtu siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
27. Në këtë rast, parashtruesit i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë, para Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, dhe atë në dy raste. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
28. Përfundimisht, kushtet për pranueshmëri nuk janë përmbushur në këtë kërkesë. Ai ka dështuar të theksojë dhe mbështesë me dëshmi se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
29. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës që parasheh: “Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

## PËR KËTË ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56 paragrafi 2 dhe rregullin 36 (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 nëntor 2011, njëzëri:

### VENDOSI

- I. TA HEDHË poshtë kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović

Prof. dr. Enver Hasani

